



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK
SEKRETARIATI TEKNIK
VENDIM
Nr.9, Datë 02.02.2022

PËR
MIRATIMIN E RREGULLOREVE DHE KRITEREVE TË KONKURISIT TË
PRANIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023,
TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të, Nenit 38-Funksionet e Senatit Akademik, *e vijim* - të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”, shkresës Nr. 13 prot., datë 26.01.2022, të Fakultetit të Artit Skenik, Senati Akademik i UART, pasi diskutoi mbi “Rregulloret dhe Kriteret e konkursit të pranimit për vitin akademik 2022-2023, të Fakultetit të Artit Skenik, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve” relatuar nga Dekani i FAS,

V E N D O S I:

1. Miratimin e “Rregulloreve dhe Kriterëve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2022-2023, të Fakultetit të Artit Skenik, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë “Bachelor” dhe cikli i dytë i studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”.

Bashkëlidhur, Rregullorja dhe kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të parë me kohë të plotë “Bachelor” si dhe Rregullorja dhe Kriteret e konkursit të pranimit të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë “Master i Arteve”, të Fakultetit të Artit Skenik.

2. Rregulloret dhe kriteret e konkursit të dërgohen zyrtarisht në MAS, në QSHA si dhe të përditësohen në portalin U-ALBANIA.
3. Ky Vendim, të publikohet në faqen zyrtare të UART sëbashku me rregulloret dhe kriteret e konkurseve të pranimit të miratuara për vitin akademik 2022-2023.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK
SEKRETARIATI TEKNIK

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)

